



BASHKIMI EVROPIAN

DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN

**Shkup, 19 shtator 2013**

**Konferencë për shtyp**  
**Panairi i Librit dhe Dita Evropiane e Gjuhëve në suaza të**  
**Programit Kulturor i BE-së**  
**[Qendra Informative e BE-së]**

Fjalim

Aivo ORAV

Shef i Delegacionit të BE-së

**E nderuara ministreshë Kançeska-Milevska,**

**E nderuara zj. Prentoska,**

**Zonja dhe zotërinj,**

- Kam kënaqësinë t'ju dëshiroj mirëseardhje të gjithëve sot në Qendrën Informativë të BE-së, me rastin e **Programit Kulturor të BE-së – Panairin e Librit dhe Ditën Evropiane të Gjuhëve 2013.**
- Së pari, më lejoni t'i falënderohem Ministrisë së Kulturës për bashkëpunimin e tyre të shkëlqyeshëm në promovimin e Programit Kulturor të Bashkimit Evropian.
- Ky Panair i Librit është vazhdim i përpjekjeve tona të përbashkëta për t'i afruar qytetarët me dobitë e Programit Kulturor dhe për t'i informuar ata mbi mundësitë e BE-së në financimin e operatorëve kulturorë.
- Këtë javë në Qendrën Informativë të BE-së do të ekspozohen 165 tituj të përkthyer në suaza të pjesës letrare të Programit Kulturor. Do të organizohen lexime letrare me autorët dhe me mysafirë nga Hungaria, Bosnja e Hercegovina, Sllovenia, Lihtenshtajni, Serbia dhe Holanda, si dhe tribuna mbi përkthimet e Homerit dhe dramave të tjera të lashta greke dhe romake, të simbolistëve francezë. Një lexim i veçantë letrar do të

organizohet për fëmijë, me shpresë që kjo do të shtojë dashurinë e tyre për librat në këtë epokë të internetit.

- Si pjesë e këtij programi të pasur, më 26 shtator, ne do të shënojmë **Ditën Evropiane të Gjuhëve** bashkë me Ambasadorën e Francës, zj. Auer, dhe me disa profesorë dhe përkthyes të mirënjohur, të cilët do të flasin mbi përvojën e tyre në përkthimin e veprave letrare.
- Dita Evropiane e Gjuhëve shënohet çdo vjet që nga viti 2001, me lartësimin e shumëllojshmërisë gjuhësore dhe me anë të promovimit të mësimin të gjuhës.
- Në fakt, ne shfrytëzojmë këtë rast të shpallim **Konkursin** e parë **për Përkthyes të Ri më të mirë** të titulluar "**Babilon**", të cilin e organizojmë bashkë me shoqatën vendore të përkthyesve. **Qëllimet** e këtij konkursi janë të inkurajojnë dhe avancojnë përkthyesit e rinj, si dhe të nxisin përsosmërinë në përkthimin e veprave letrare nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian. Konkursi do të shpallet zyrtarisht **më 2 dhjetor** duke përfshirë **kriteret e detajuara për dorëzimin e aplikacioneve**.
- Leximi i librave na sjell në kohëra dhe në vende që nuk kemi qënë më parë. Falë shtëpive botuese dhe bashkëpunimit të ngushtë me ambasadat e Shteteve Anëtare të BE-së, këtë javë do të kemi kënaqësinë të jemi në shoqëri me disa nga autorët e mirënjohur evropianë të

ditëve të sotme, siç janë Gyorgy Konrad, Iren Nigg, Rodaan al Galidi, Dusan Chater dhe Melina Kameric - të cilët janë këtu sot me ne.

- Shumë ju falemnderit për vëmendjen.